



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 29.10.2025
Numër Protokoli: 7074/2025

A.nr.1258/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedura sipas ankesës me numër A.nr.1258/2025, të datës 01.07.2025, të parashtruar nga ankuesja M.H, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Armend Shkoza, nga Mitrovica, kundër organit të punësimit: Komuna e Zveçanit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1258/2025, e datës 01.07.2025, e parashtruar nga ankuesja M.H, ashtu që, **anulohet** Njoftimi i datës 05.06.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Zveçanit, për shpalljen e rezultateve përfundimtare në procedurën e pranimit më Nr. Ref: RN00017565, për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime Publik* si dhe çdo veprim administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe fazën e vlerësimit profesional, **ndërsa, çështja kthehet në fazën e verifikimit paraprak.**

II. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Zveçanit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, siç përcaktohet në pikën I të dispozitivit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, M.H (*tutje referuar: Ankuesja*), me datë 27.06.2025, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 01.07.2025 dhe regjistruar nën shenjën A.nr.1258/2025, kundër Njoftimit të datës 14.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Zveçanit për refuzimin e aplikacionit, lidhur me konkursin me Nr. Ref:RN00017565, për Grupin e Shkencave Shoqërore, pozita *Zyrtar për Shërbime Publike*, i shpallur nga Komuna e Zveçanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Zveçanit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 18.07.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4440/2025 të datës 01.07.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 28.05.2025; Konkursin me numër reference RN00017565 ; Njoftimin për verifikim paraprak i datës 14.05.2025; Vërtetimin e datës 02.05.2025; Aneks marrëveshjen datës 18.08.2024; Marrëveshjen e datës 15.05.2024; Përgjigjen në kërkesë e datës 04.12.2024 dhe 26.03.2025; Certifikatën për periudhën 18.04.2024 deri 17.12.2024; Zarin e datës 27.06.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2025; Përgjigje në ankesë e datës 18.07.2025; Lista e aplikantëve; Njoftimin për verifikim paraprak i datës 14.05.2025; Njoftim për rezultatet përfundimtare i datës 05.06.2025; Vendimi i datës 01.04.2025 për fermiumin e komisionit të pranimit; Akt emërimit për M.K i datës 02.03.2020; Vendimi i datës 15.10.2024; Vendimi i datës 14.04.2025; Akt emërimi i A.G i datës 25.06.2025; Akt emërimi i M.B e datës 20.11.2024; Akt emërimi i L.K e datës 20.02.2013; Akt emërimi i B.P i datës 21.04.2022; Aplikacionin e datës 02.05.2025 të ankueses së bashku me dokumentacionin e dorëzuar nga faqe 1-23; Aplikacionin e datës 07.05.2025 të kandidatit fitues së bashku me dokumentacionin e dorëzuar nga faqe 1-7.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se Komuna e Zveçanit më datë 07.04.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00017565, Grupi i Shkencave Shoqërore, gjegjësisht për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime Publike*, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike edhe Infrastrukturës, klasa profesional 1, me afat aplikimi 08.04.2025 deri 07.05.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar ankuesja, mirëpo që të njëjtës sipas njoftimit të datës 14.05.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Zveçanit, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin: *Kopjet e dëshmisë së punësimit, (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet se paku njërin nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatime për të ardhurat personale.*

Më datë 05.06.2025 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Zveçanit, ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare, sipas të cilit akt si kandidat fitues për pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime Publike* , është shpallur L.Z me gjithsej 80.4 pikë të arritura.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shton ligjshmërinë e Njoftimit të datës 14.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Zveçanit për refuzimin e aplikacionit, duke pretenduar së akti i kundërshtuar me ankesë është nxjerr pa një argumentim të gjendjes faktike dhe pa shqyrtim të tërësishëm të provave të çështjes, konkretisht, i është mohuar faktin se pala ankuese ka qenë e angazhuar si praktikante prej 12 muaj në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Mitrovicës së Jugut, kështu që, në këtë aspekt nuk është e nevojshme dokumenti i mbulueshmërisë së kontributeve pensionale pasi që është praktikë në institucion publik. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet akti i kundërshtuar

me ankesë.

Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me Nr. Ref: RN00017565 për Grupi i Shkencave Shoqërore, gjegjësisht, për pozitën e punës “Zyrtar për Shërbime Publike”, dhe si rrjedhojë ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme formale janë vendosur: **Arsimimi i kërkuar: Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), Juridike, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës,**

Në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”,*

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe nenin 6, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 2.*Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor Kolegji ka analizuar Njoftimin të datës 14.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Zveçanit për refuzimin e aplikacionit të ankueses, dhe si rrjedhojë konstatoi së njoftimi është i paqartë dhe nuk pasqyron në mënyrë konkret dhe të kuptueshme arsyen dhe shkaqet e refuzimit të aplikacionit të ankuesi dhe si tillë nuk bazohet në vërtetim të drejt të gjendjes faktike, sepse, nga analizimi i dokumentacionit të ankesës të dorëzuar më rastin e aplikimit dhe i përcjell nga organi i punësimit përmes përgjigjes më ankesë, rrjedhë se ankuesja posedon Diplomën me Nr. 8274 të datës 27.09.2023, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohej se më datë 25.09.2023, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filozofik, duke marr titullin Bachelori i Sociologjisë, ndërsa, sa i përket përvojës së punës e njëjta posedon: Vërtetimin Nr. 12-113/04-0025749/25 të datës 02.05.2025, të lëshuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, e përmes të cilit dëshmohej se njëjta ka qenë e angazhuar në praktikë prej datës 18.04.2024 deri më datës 30.04.2025 (dymbëdhjetë muaj) me orar të plotë prej tetë (8) orësh në ditë në Sektorin e Kulturës Rinisë dhe Financave, ashtu që për periudhën prej tetë (8) muaj me pagesë përmes programit Reload 2 një marrëveshje e lidhur mes Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe UNDP, ndërsa, periudha tjetër ka qenë pa kompensim. Në vlerësimin e Kolegjit Njësia përgjegjëse ka dështuar në aplikimin e drejtë të së drejtës materiale më rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses, mbi faktin së ankuesja ka plotësuar kriteret formalë lidhur me pozitën përkatëse, pasi që puna praktike pas diplomimit pavarësisht se a përcillet me kompensime apo jo kompensim konsiderohet përvojë profesionale pas diplomimit ashtu siç parashihet me nenin 16

të Ligjit të Punës Nr. 03/L212, kështu që, Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Zveçanit, si njësi përgjegjëse në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ka vepruar në kundërshtim me nenin 39 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1, të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe nenin 7, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil.

Andaj, bazuar si më sipër, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, vendosi që të aprovoj si të bazuar, të anuloj njoftimin e datës 05.06.2025 për rezultatet përfundimtare, njoftimin e datës 14.05.2025 për refuzimin e aplikacionit të ankueses dhe të gjitha veprimet e ndërmarra në fazën e vlerësimit profesional duke e kthyer çështjen në fazën e verifikimit paraprak, me detyrimin që njësia e personelit të organit publik në këtë rast të Komunës së Zveçanit në rivlerësim të aplikacioneve të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe në listë të ngushtë të përfshijë kandidatët që plotëson kriteret formale të kërkuar më konkursin e kontestuar.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër: A.nr.1258/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhinikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat Armend Shkoza;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Zveçanit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.